



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1720 prot.

Tiranë, më 20.12.2019

VENDIM
Nr. 194, datë 20.12.2019

“PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.12.2019, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, institucion varësie i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion, i cili është raportuar nëpërmjet shkresës nr. 7070/1 prot., datë 22.08.2019, për institucionet e varësisë, duke evidentuar punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për institucionin Agjencia Kombëtare e Mjedisit është raportuar se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësit:

- *****, “*Specialiste Finance*”, në Sektorin e Shërbimeve, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 01.01.2016;

- ******, “*Specialist i Lejeve Mjedisore dhe VNM*”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 22.12.2018;
- ******, “*Përgjegjës*”, në Sektorin e Cilësisë së Mjedisit, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 01.11.2019;
- ******, “*Drejtor*”, në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Berat, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 25.05.2019;
- ******, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Mjedis, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 16.02.2019;
- ******, “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Shërbimeve, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 31.01.2019.

Në vijim, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 167, datë 10.12.2019, ka vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësit e mëposhtëm:

- ******, “*Specialiste Finance*”, në Sektorin e Shërbimeve;
- ******, “*Specialist i Lejeve Mjedisore dhe VNM*”;
- ******, “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Cilësisë së Mjedisit;
- ******, “*Drejtor*”, në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Berat;
- ******, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Mjedis;
- ******, “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Shërbimeve.

2. Pozicionet respektive të punës, të raportohen pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicione të lira dhe DAP të vijojë procesin për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga marrja dijoni për këtë vendim.

...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 167, datë 10.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Kombëtare e Mjedisit për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, institucioni i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit përmes shkresës së dërguar me nr. 5802/1 prot., datë 19.12.2019, me objekt: “*Mbi zbatimin e vendimit nr. 167, datë 10.12.2019*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1720/4 prot., datë 20.12.2019, ka raportuar pranë këtij të fundit,

masat e marra nga institucioni në kuadër të realizimit të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues nr. 167, datë 10.12.2019, të Komisionerit, si më poshtë vijon:

Për dy nëpunësit, *****, me detyrë “*Specialist i Lejeve Mjedisore dhe VNM*”, në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Elbasan dhe *****, me detyrë “*Drejtor*”, në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Berat, është ndërprerë marrëdhënia në shërbimin civil.

Ndërsa, për nëpunësen *****, me detyrë “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Cilësisë së Mjedisit, u verifikua edhe një herë momenti i daljes në pension të plotë pleqërie dhe sipas akteve ligjore në fuqi, rezulton se, data e daljes në pension për këtë punonjëse është data 31.01.2020.

Përsa i takon tre punonjësve të tjerë, për të cilët Komisioneri ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie, insitucioni Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka argumentuar se, sipas VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*” dhe VKM-së nr. 570, datë 17.07.2019, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve*”, ky institucion është në proces ristrukturimi, si rrjedhojë, për shkak të nevojave dhe për përmbushjen e detyrave funksionale nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit gjatë këtij procesi, ky i fundit ka kërkuar shtyrjen e afatit për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësit:

- *****, “*Specialiste Finance*” në Sektorin e Shërbimeve;
- *****, “*Drejtor*” në Drejtorinë e Vlerësimit në Mjedis;
- *****, “*Përgjegjëse*” në Sektorin e Shërbimeve.

Në analizë të sa më lart përmendur vërej se:

Në kushtet kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për tre punonjësit e lartë përmendur, do të krijonte pengesa për institucionin Agjencia Kombëtare e Mjedisit në realizimin e procesit të ristrukturimit, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 167, datë 10.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Agjencia Kombëtare e Mjedisit për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, për këta punonjës, nga ana e institucionit Agjencia Kombëtare e Mjedisit është e ligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, kreu IV “*Rishikimi*”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 167, datë 10.12.2019, me përmbajtje si më poshtë:

Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjësit:

- ******, *me detyrë “Specialiste Finance”, në Sektorin e Shërbimeve;*
- ******, *me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Vlerësimit në Mjedis;*
- ******, *me detyrë “Përgjegjëse”, në Sektorin e Shërbimeve,*

deri në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha